



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:050612
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05491519

C – IV. – 14 - 0903

Paditësja :

Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Radoniqi” SH.A, me seli në Gjakovë e tani Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kërkesa për kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.22.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Radoniqi” SH.A, me seli në Gjakovë e tani Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë e parashtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimi, PRZ020 -0146 i dt.27.01.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 18 Shkurt 2014, Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Radoniqi” SH.A, me seli në Gjakovë e tani Kompania Rajonale e Ujësjetës (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ020 - 0146 i dt.27.01.2014, e me të cilin Vendim kërkesa e

ankueses/paditëses për kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 988.14 €, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007, është refuzuar plotësisht e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së.

Në arsyetimin e Vendimit të kundërshtuar të AL-së, thuhet se kërkesa është paraqitur me 15 mars 2011 që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, e cila është bërë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, e duke cituar edhe nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në, AL-ja, pas shqyrtimit të kërkesës, e vlerëson atë si plotësisht të pranueshme, se ka cituar nenin 374 të LMD-së, i cili parashikon se : *"Pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet"*, si dhe nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në, që parashikon se : *"elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*, e në varësi të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jenë paraqitur në gjykatë apo te ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare e që është tre vite nga viti 2002 kur parashtrueses, nuk i është kryer pagesa e faturave, e për më tepër Kompania Rajonale e Ujësjetësimit (KRU) "Radoniqi" SH.A, me seli në Gjakovë, është e njoftuar nga AKP-ja, se të gjitha obligimet të cilat faturohen pas datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes së Akcioneve të Zakonshme të NEW CO, "1 Maji", Xërxë – mermer dhe Beton L.L.C, datë e cila është 12 qershor 2007, duhet të faturohen në emër të pronarit të Ndërmarrjes së Re, "1 Maji Xërxë – Mermer dhe Beton L.L.C.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si *"kërkesë për ri shikim të Vendimit"*, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet *"njsja e procedurave"* pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Në pretendimet e tij më tej thekson se AL-ja, me rastin e vendosjes bazohet në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në se kërkesa apo pretendimi qenka i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme konform dispozitës ligjore në fjalë, se KRU "Radoniqi" SH.A, me seli në Gjakovë, konsideron se ky vlerësim i këtij autoriteti është në kundërshtim me arsyetimin e vendimit, kur vërtetohet nga citati i tij se : *"Kërkesa është paraqitur me 15 mars 2011 që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave"*, se ai brenda afatit të caktuar kohor konform nën par.1.3 të parag.1 të nenit 17 të Ligjit për AKP-në si dhe formularit të dërguar nga ky autoritet ka parashtruar pretendimet e saj ndaj NSh-së në likuidim për borxhin e kompensimit të ujit të pijes, se vendimi mbështetur në nenin 374 të Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (i publikuar në Gazetën zyrtare të RSFJ, Nr.29/1978), se "në varësi të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jenë paraqitur në gjykatë apo te ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare", KRU, "Radoniqi" SH.A, e kundërshton në tërësi, së pari nuk ka parashkrim të kërkesës karshi një autoriteti jo gjyqësor, se i pa konstestueshëm është fakti i ekzistimit të parashkrimit të kërkesës për nxjerrjen e borxheve përmes rrugës gjyqësore, se ky fakti në të cilin është bazuar Vendimi i AL-së, është në kundërshtim me procedurën e privatizimit me të cilën ka udhëhequr ky Autoritet deri më tani, se pezullimin e lëndëve nga e paditura tek Dhoma e Veçantë deri në procesin e likuidimit, njoftimi në këtë proces që ju ka bërë kreditorëve në lidhje me borxhet e NSh-ve që po privatizohet, si dhe afati i paraqitjes së kërkesës për pretendimet e tyre, me të cilën gjatë tërë kësaj procedure të aplikimit pretenduesi i kërkesës, KRU "Radoniqi", ju ka përmbajt në tërësi.

Tutje ka shtuar se paditësja vlerëson se ky është një diskriminim që po iu bëhet kreditorëve në këtë drejtim duke vlerësuar kërkesat si të parashkruar nga një autoritet jo gjyqësor, se borxhi nuk konsiderohet se është vjetërsuar ajo çka është konsumuar edhe duhet paguar, se në fillim të procesit të likuidimit të borxheve të NSH-ve, pretendimet e kreditorëve, janë likuiduar duke e vlerësuar; Formulari i kërkesës që ky autoritet ia ka dërguar çdo kreditori për kërkesat ndaj NSH-së në likuidim, provat me të cilën është argumentuar borxhi i kërkuar si dhe iu ka përmbajtur kreditori afatit të caktuar të pranimit të kërkesave sipas këshillës në Formular ndërsa më vonë me Shtojcën e Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, me qëllim të vlerësimit të këtyre borxheve si të pas afatshme nxirret Shtojca, Nr.04/L – 034 për AKP-në e me të cilën diskriminohen kreditorët duk i konsideruar borxhet e tyre si të pas afatshme me të vetmin qëllim që nga fondi për pagesën e borxheve që NSH-të, ndaj kreditorëve të mos ju paguhen asnjëherë, andaj në kuptim të pretendimeve ankimore, Dhomë së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i ka propozuar që kërkesën për një ri shikim të Vendimit, t'a aprovoj si të bazuar.

Padisë si prova, paditësja, i ka bashkangjitur: kërkesat për pagesë të KRU, "Radoniqi" SH.A, Gjakovë për institucionin, NSH, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim) për vitet 2002 – 2007e në totalin e kërkesës në shumën prej 988.19 €, 12 (dy mbëdhjetë) faturat për shpenzimet e ujit për NSH, "1 Maji" me seli në Rahovec për vitet 2002 dhe 2003 e duke filluar prej faturës së dt.28.02.2003 e deri te fatura e dt.31.03.2002 por jo edhe Vendimin i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ020-0146 të dt.27.01.2014.

Me dt.09.3.202016, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PRZ020-0146 të dt.27.01.2014, se i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, duke pretenduar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria i vendimit të AL, dhe se ankesat duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me nenin 70.2 të Ligjit Nr.04/L – 033 për AKP-në, se lidhur me pretendimin se e paditëses se vlerësimi i AL-së, është në kundërshtim me vendimin, e paditura si palë kundërshtare, ka theksuar se ekzistojnë dy afate të cilat paditësja, ishte e i obliguar që t'i respektoj, i pari është "afati për dorëzimin e kërkesave", i cili është një afat brenda të cilit dorëzohet, "dëshmia e kërkesës" në procedurën e likuidimit, se ky afat thjeshtë e bënë kërkesën të jetë e pranueshme nga AL-ja dhe nuk ka të bëjë me meritat e çështjes kurse afati i dytë, ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës, zbatimi i së cilës është kërkuar nga paditësja edhe pse e paditura në këtë mbrojtje, referon gabimisht në ndonjë lëndë tjetër në Gjykatën Komunale në Gjilan).

Tutje e paditura, ka shtuar se paditësja, pretendon se AL-ja, si autoritet jo gjyqësor, nuk mund të vlerësojë mbi parashkrimin e një kërkesë, e për këtë e paditura, si palë kundërshtare ka theksuar se AK-ja, ushtron përgjegjësitë e veta ligjore në bazë të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034, ku nëpërmjet nenit 18.1.16, është i autorizuar të vlerësojë kërkesën e dorëzuar nga paditësja me dt.15 mars 2011 e nga ana e tjetër, neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në së bashku me nenin 37.4 i po të njëjtit ligj, jo vetëm që e autorizon më tej por e detyron, AL-në, të refuzon me Vendim në bazë të parashkrimit, se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në, e obligon se AL-në të zbatoj afatet e përcaktuara të kufizimit gjatë procesimit të kërkesave të kreditorëve ndaj NSH-ve, se përveç nenit 36.2.1, neni 37 par.4.1 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në, qartësisht thotë se: "... kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi" e këto dispozita nuk lënë dyshim mbi faktin se AL-ja, është e obliguar të zbatoj ex officio, afatet e kufizimit, se nenin 374 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, Nr.29/78 1978), vërtetë parashikon se:

”Pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet”, se kësisoji AL-ja, veproj drejtë duke gjetur se kërkesa është e parashkruar prej viti 2005, tre vite pas detyrimit të fundit të krijuar në bazë të kërkesës së parashtrueses, këtu paditëses, pra kërkesa është paraqitur shumë më vonë se sa ishte parashkruar në vitin 2005 e për më tepër, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit (KRU) “Radoniqi” SH.A, me seli në Gjakovë, ishte e njoftuar nga AKP-ja, se të gjitha obligimet të cilat faturohen pas datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes së Akcioneve të Zakonshme të NEW CO, ”1 Maji”, Xërxë – mermer dhe Beton L.L.C, datë e cila është 12 qershor 2007, duhet të faturohen në emër të pronarit të Ndërmarrjes së Re, ”1 Maji Xërxë – Mermer dhe Beton L.L.C dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe t’a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 - 0903 të dt.11.03.2024, kjo gjykatë, ia ka dërguar paditëses, Mbrojtjen (përgjigjen) e të paditurës.

Me dt.19.03.2023, paditësja, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtesën e dt.19.03.2024, e në të cilën ka paraqitur përgjigje në Mbrojtjen e të paditurës epërmes secilës e ka njoftuar gjykatën për ndryshimet në stansi e saj si Ndërmarrje Publike, pra ka emërtim të ri, si Kompania Rajonale e Ujësjiellësit (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë, dhe se kësaj parashtrese ia ka bashkangjitur Vendimin i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ020-0146 të dt.27.01.2014 por edhe disa prova tjera, siç janë : ekstrakti nga librat e kontabilitetit të dt.19.03.2024 për vitet 2003 – 2014 për NSh, ”1 Maji” me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 1,182.39 € dhe certifikatën e regjistrimit, nr.70433554 të Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) me seli në Prishtinë për Kompaninë Rajonale të Ujësjiellësit (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme DhPGJSK)), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”.*

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses, refuzohet si e pa bazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se NSh, ”1 Maji” me seli në Rahovec (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.31 Dhjetor 2010, ndërsa paditësja kërkesën tek AL-ja, e ka paraqitur me dt.15.03.2011 dhe se e AL-ja me Vendimin, PRZ020-0146 të dt.27.01.2014, kërkesën e ankuses/ paditëses për kompensimin e

faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 988.14 €, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007 nga NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim), e ka refuzuar tërësisht e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së derisa paditësja, pas pranimit të këtij Vendimi në procedurën e likuidimit me dt.30.01.2014, ankesën/padinë kundër Vendimit të AL-së, PRZ020-0146 të dt.27.01.2014, pranë DhPGJSK-së, e ka paraqitur me dt.18.02.2014, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimit të tij dhe se pjesë e padisë/ankesës së saj, është edhe Vendimi i kontestuar i AL-së, PRZ020-0146 i dt.27.01.2014.

Gjykata, pra vlerëson se padia/ankesa e paditëses, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse, pra paditësit dhe të paditurës, NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim), ka ekzistuar raporti i furnizimit me ujë për të cilën kjo vërtetohet me faturat respektive si dhe ekstraktet nga librat e kontabilitetit dhe se nuk është kontestuese se paditësja, ka kërkuar që nga NSh-ja, të realizoj kompensim shumën e pretenduar prej 988.14 € të faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim) e duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007 por e cila e cila kërkesë, është refuzuar nga AL-ja, me Vendimin e tij, PRZ020-0146 të dt.27.01.2014 dhe me atë se pretendimet e parashtrueses e këtu paditëses, janë të pabazuara dhe të parashkruara nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL-ja, ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se *"elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*, dhe nga neni 374 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (1978) parashikon se : *"Pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet"* por kontestuese na paraqitet fakti se paditëse, a i është parashkruar kërkesa për kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 988.14 €, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007 nga NSh, "1 Maji" me seli në Rahovec (në likuidim).

Në rastin konkret, gjykata gjen se kemi të bëjmë me kërkesa e pa siguruar nga neni 40 par.1 pika 1.7 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L – 034 për AKP-në që bënë fjalë për Prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty thuhet se : *"Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: 1.7.kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë ..."*

Në nenin 42 par.3 i Ligjit nr. 06/L – 086 për Dhomën e Posaçme, në mënyrë shprehimore, thuhet se : *"... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë"* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *"Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*.

Në këtë çështje juridike gjykata gjen se kemi të bëjmë me kërkesat e pa siguruara, pra kërkesa për pagesën e faturave të pa paguara për periudhën gjegjëse kohore dhe në shumën e lartëcekur dhe se e paditura, AL-ja, me rastin e vendosjes se kërkesa e paditëses, është e pas afatshme sipas dispozitave të zbatueshme ligjore nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në lidhur me nenin 374 të LMD-së (1976), pasi që kërkesat periodike, afati iu ka rrjedh veç e veç, si dhe çdo kërkesë e veçantë mujore eventuale, duhet të argumentohet me prova konkrete materiale e për të cilën pala paditëse, nuk ka arritur të dëshmoj një fakt të tillë.

Në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 , që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë''*.

Për kërkesat e veçanta gjegjësisht kërkesat për kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, ''1 Maji'' me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 988.14 €, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007 nga NSh, ''1 Maji'' me seli në Rahovec (në likuidim), sipas faturave dhe ekstrakteve nga librat e konsumatorit, NSh, ''1 Maji'' me seli në Rahovec (në likuidim), e argumentojnë dispozitat nga neni 36.2.1 dhe 2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në lidhur me nenin 374 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), pasi që pretendimet e parashtrueses – paditëses, i referohen periudhës kohore 2002 - 2007, sipas ekstrakteve nga librat e konsumatorit, për të cilën me kalimin e afatit prej tre vjetëve nga viti 2002, konstaton se janë të pas afatshme dhe të parashkruara siç pretendon edhe pala e paditur, ndërsa pretendimet e paditëses lidhur me ekstraktet nga librat e konsumatorit për periudhën 2003 – 2014, janë shkresa – provë me përmbajtje të kërkesës gjerë në vitin 2014, dhe nuk përcakton ndonjë rrjedh të kërkesës së vazhdueshme, se pala e paditur, nuk ka bërë ndonjë pagesë të detyrimit në të holla kurse paditësja, nuk ka prova se para dt.15 Mars 2011, të ketë iniciuar procedurën gjegjëse ligjore për realizimin e kredisë së saj të pretenduar në të holla – kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, ''1 Maji'' me seli në Rahovec (në likuidim) e që të kishte ndërprerje të afatit të parashkrimit për vitet gjegjëse. Pra në rastin konkret, gjykata konsideron se kërkesa kanë të bëjnë në mes dy personave juridik si dhe është shfrytëzuar për çështje të biznesit e jo për nevoja të amvisërisë dhe se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, është i bazuar dhe i drejtë qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e AL-së, kur kërkesën e paditëses në emër të kompensimit në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, ''1 Maji'' me seli në Rahovec (në likuidim) duke e konsideruar si të pas afatshme dhe të parashkruar sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, lidhur me nenin 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) dhe se qëndrimi i AL-së në kërkesën e parashtruar të paditësi të cilën e ka refuzuar e duke vlerësuar si të të kërkesën, bazohet në obligimet e palëve në procedurë se në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi, dhe pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) dhe për të cilën pala paditëse nuk ka paraqitur para kësaj gjykate vendimmarrëse, por edhe qëndrimin e AL-së të shprehur në Mbrojtjen e saj, se duhet të bëhet dallimi i afateve për dorëzimin e kërkesave, në procedurën likuidimit i cili është

një afat brenda të cilit dorëzohet , dëshmia e kërkesës, se ky afat thjeshtë e bënë kërkesën të jetë e pranueshme nga AL-ja dhe afatin i dytë, ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës, andaj gjykata me arsyet e cekura më lartë, e refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit (KRU) “Radoniqi” SH.A, me seli në Gjakovë e tani Kompania Rajonale e Ujësjiellësit (KRU) “Gjakova” SH.A, me seli në Gjakovë për kompensimin e faturave të pa paguara në lidhje me furnizimin me ujë të ndërtesës së NSh, ‘’1 Maji’’ me seli në Rahovec (në likuidim) në shumën prej 988.14 €, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2007 dhe Vendimin, PRZ020 -0146 të dt.27.01.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, e vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2023:050612, 22.03.2024**

Gjykatësi
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).